

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 7996/26

Nr. i fq. / Br. st. - 5 -

Data: / Datum: 23.02.2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 32/26, 23.02.2026

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27 janar 2026
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:05.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Kushtrim Hyseni, Xhon Gubetini, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, Ymer Haradinaj dhe Gentiana Rama (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës), Shpëtim Zhegrova (Nënkryetar i Komunës), drejtorët e drejtorive, si dhe Azem Bejta nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na ka ardhur edhe një pikë shtesë për ta shtuar në rend të ditës:

- Rishqyrtimi i vendimit nr.65281/25, i datës 30.12.2025, për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026.

Komiteti për Politikë dhe Financa me katër (4) vota “për”, një (1) “kundër”, aprovoi këtë pikë që të shtohet në rend të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri “për” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Raporti vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025;
2. Propozim – vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në NPL “Përparimi” në Vushtri;
3. Propozim – vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në KRM “Uniteti” në Vushtri;
4. Propozim – vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2026 – 2028;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrrisë;
6. Rishqyrtimi i vendimit nr.65281/25, i datës 30.12.2025, për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026;
7. Pyetje dhe përgjigje.

1. Raporti vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se duke u bazuar në planin e punës, drejtoria ka hartuar raportin e shpenzimeve për vitin 2025, konform tabelave buxhetore, planifikimit, alokimit dhe shpenzimit të buxhetit. Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit, në bazë të kategorive ekonomike është si vijon: granti qeveritar- buxheti i planifikuar ka qenë 24,992,828.25€, kurse buxheti i realizuar është 24,936,221.95€, përqindja e realizimit është 100%. Te të hyrat vetanake-fondi 21, buxheti i planifikuar ka qenë 3,895,024.75€, kurse buxheti i realizuar është 3,886,480.56€, përqindja e realizimit është 100%. Kurse, mjetet e bartura nga fondi 22 kanë qenë 1,007,972.29€, ndërsa të realizuara janë 1,006,740.38€.

Donacionet e brendshme të planifikuara janë 3,623.23€. Kurse, donacionet e jashtme kanë qenë 23,780.39€.

Gjithsej buxheti i planifikuar ka qenë 29,923,228.91€, kurse i realizuar është 29,840,984.82€, përqindja e realizimit është 100%. Edhe pse kemi pasur shumë sfida të mëdha me vendimet gjyqësore dhe përmbarimore, por prapëseprapë ky planifikim në tërësi është realizuar dhe projektet kapitale që i kemi pasur të planifikuara janë realizuar. Kurse. Projektet dyvjeçare dhe trevjeçare janë në procedurë për këtë vit dhe vitin e ardhshëm për finalizimin e tyre.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – sa i përket kësaj pike, ne si grup do t'i paraqesim të gjitha vërejtjet tona në mbledhjen e kuvendit të komunës, që do të mbahet më 29 janar 2026. Mirëpo, desha t'ja bëj një pyetje drejtorit: Në bazë të tabelave shihet se kemi realizim 100% të projekteve dhe ky është një lajm i mirë. Megjithatë, nëse e shohim në praktikë, shumë projekte nuk janë realizuar. Kurse, shumica e buxhetit, i cili ka qenë i planifikuar për projekte kapitale dhe projekte të ndryshme është shpenzuar për vendime gjyqësore dhe përmbarimore. Prandaj, shumë projekte kanë mbetur pa u përfunduar, duke përfshirë edhe projektet kapitale. Ajo që është brengosëse është se mjetet janë shpenzuar, kurse projektet nuk janë realizuar. Qytetarët edhe sot (kur jemi në vitin 2026) kanë mungesat elementare bazike për jetë, siç janë: uji, kanalizimi, trotuari, ndriçimi publik (i cili në shumicën e territorit të komunës nuk funksionon). Kurse, arsyetimi i vazhdueshëm i kryetarit të komunës në fund të mandatit të kaluar ka qenë që kemi pasur shumë shpenzime përmbarimore.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – deklaroi se me rastin e planifikimit të buxhetit, projektet e aprovuara në vitin 2025, 99% janë përfunduar të gjitha. Kurse, projektet dyvjeçare dhe trevjeçare janë në procedurë, kurse puna nuk ka ngecur asnjëherë.

Pas debatit këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

2. Propozim – vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në NPL “Përparimi” në Vushtrri.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Propozim – vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në KRM “Uniteti” në Vushtrri.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Propozim – vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2026 – 2028.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me rastin e hartimit dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2026 – 2028 (sipas Qarkores buxhetore 01/2026 dhe 02/2026), ku vitin e kaluar është aprovuar ky buxhet në kuvend. Vendimi nuk ndryshohet, pra as kufijtë buxhetorë nuk do të ndryshohen. Mirëpo, pasi që në nivelin qendror nuk është aprovuar ende buxheti, kemi hapësirë për modifikim dhe plotësim të tabelave 4.1 dhe 4.2, sa herë që shihet e nevojshme me vendim të kuvendi. Me qarkoren buxhetore, komisioni i granteve ka paraparë një shumë buxhetore për një shtëpi të komunitetit për të moshuar në shërbime rezidenciale. Për vitin 2026, në qarkoren buxhetore, me plan kanë qenë 230 mijë euro, në vitin 2027 kanë qenë 200 mijë euro, në vitin 2028 kanë qenë 200 mijë euro. Për ta futur në tabelë buxhetore, kemi qenë të obliguar që ta përgatisim këtë propozim-vendim. Po ashtu, edhe për disa projekte tjera që i keni në material, kemi bërë një reduktim të shumës buxhetore dhe një plotësim për këtë destinim. E kemi një projekt, që po e kemi në vazhdimësi – “Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra”, një shumë financiare 40 mijë euro. Po ashtu, është një propozim i Drejtorisë për Shërbime Publike, nga fondi për Bashkëfinancim me Donatorë, shuma prej 80 mijë euro për blerjen e një automjeti dhe të futet në tabelën 4.2. Po ashtu, kemi një propozim në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve, ku kemi projektin dyvjeçar për renovimin e <banesave të bardha>

Prandaj, për këto propozime që janë bërë, ka afat ligjor për modifikim.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tabelat që i keni sjell tani për t’i ndryshuar, me këto tabela është bërë buxheti i komunës. E kam thënë edhe në seancën kur është miratuar buxheti, se jemi duke e aprovuar buxhetin jashtë afateve ligjore pa asnjë arsye. Ka mundur që të aprovohet buxheti në muajin shtator e mos të ketë vonesa të tilla, për shkak të premtimeve parazgjedhore e keni shtyrë buxhetin deri në muajin nëntor. Prapë po ua rikujtoj, që Ministria e Financave e themelon një komision të veçantë për aprovimin e buxhetit të komunave të caktuara, të cilat i dorëzojnë me vonesë. Çka nëse ky komision nuk e aprovon buxhetin e komunës së Vushtrrisë, dhe mbetemi në kolaps si disa komuna në vitin e kaluar. Nuk është në rregull të ndryshohen projektet, pasi që buxheti është aprovuar në muajin nëntor. Do të ishte më e drejtë të sjellet në tërësi buxheti për aprovim dhe ndoshta dikush ka ndonjë ide apo projekt që do të mund të hyjë për vitet e ardhshme.

Shpëtim Zhegrova, Nënkryetar i komunës – deklaroi se kjo pikë nuk është që ka ardhur me vullnetin e Drejtorisë së Financave e as të qeverisjes lokale. U dashtë drejtori ta sqarojë në fillim që është kërkesë e Ministrisë së Financave, jo në mënyrën më të mirë të mundshme. Ata nuk e kanë asnjë informatë për asnjë komunë të Kosovës, e veçanërisht për komunën tonë. Janë duke na detyruar ta fusim një linjë buxhetore për ndërtimin e një shtëpie të komunitetit për të moshuar, ku kjo shtëpi ekziston në Vushtrri. E aq më keq, kanë kërkuar që të futet në buxhet nga granti qeveritar. Ne e kemi njoftuar Ministrinë e Financave që Vushtrria e ka një shtëpi të komunitetit për të moshuar dhe nuk është e nevojshme të jetë pjesë e buxhetit. Prandaj, arsyeja kryesore pse ka ardhë kjo pikë është për shtëpinë e komunitetit për të moshuar. Kurse, disa ndryshime tjera që janë propozuar, ka

pasur mundësi edhe mos me ndodhë. Sikur, ministria mos të kërkonte këtë gjë, ky propozim nuk do të vinte fare për t'u ndryshuar. Komisioni që e përmendi Fatmirja në ministri, ai ka ekzistuar gjithë, sepse vendimi për buxhetin fillimisht shkon në MAPL, pastaj ata e dërgojnë në Ministri të Financave dhe kjo nuk është zbuluar tash. Asgjë jashtë afatit ligjor nuk ka qenë, ku buxheti është aprovuar në kuvend, sepse kuvendi i komunës ka qenë funksional. Sipas teje, nëse nuk kanë pasur të drejtë ta aprovojmë buxhetin në nëntor, do të thotë që mos të miratohet buxheti fare për këtë vit.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – a po i bie që është përgatitur buxheti gabimisht që e ka kthyer ministria? Prandaj, ju duhet t'i arsyetoni që të mos bëhen dy shtëpia rezidente për të moshuar ose kjo aktuale është ndërtuar nga Halil Kastrati dhe ministria nuk ka kompetenca me u marrë. Vushtria ka nevojë për një shtëpi rezidente për të moshuar, sepse kjo është vetëm qëndrim ditor gjatë orarit të punës dhe nuk punon 24 orë. Prandaj, këtë që e ka kërkuar ministria, ju duhet të keni vullnet vet që ta shtyni përpara, sepse ka nevojë që të keni një shtëpi rezidente për të moshuar.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – nënkryetari tha se buxheti nuk është miratuar me vonesë. Por, 30 shtatori është data e fundit që duhet të miratohet buxheti. Prandaj, komuna e Vushtrisë, duke qenë në presion të zgjedhjeve e ka miratuar buxhetin me vonesë. Pra, është miratuar në kohë fushate zgjedhore, ku nuk keni pasur kohë dhe hapësirë t'i planifikoni projektet. Mendoj që, do të bëni shkelje ligjore nëse ndërhyini në buxhetin që është miratuar vitin e kaluar.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – buxheti nuk po ndryshohet e as vijat buxhetore. Ndërsa, harmonizimin brenda tabelave sa herë ta shohim të arsyeshme ka bazë ligjore për ta modifikuar, korrigjuar dhe plotësuar. Ne fillimisht e kemi marrë aprovimin nga Ministria e Financave, pastaj e kemi sjellë propozim-vendimin. Ne po bëjmë ndryshim-plotësim të tabelave, e jo të vendimit të buxhetit.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota "për", dy (2) "kundër", rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrisë.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – kjo nismë ka ardhur pa asnjë arsyetim. Kur është bërë regjistrimi i popullsisë, Vushtria ka dalë nën 70 mijë banorë, ku si pasojë e kësaj është zvogëluar numri i anëtarëve të kuvendit. Në fillim të mandatit të kaluar, u ndryshua statuti dhe ju ka dhënë e drejta kryetarit të komunës që t'i bëjë deri në 14 drejtori. Prandaj, pasi që është zvogëluar numri i anëtarëve të kuvendit është mirë që të zvogëlohet edhe numri i drejtorive, në mënyrë që të kemi një efikasitet më të mirë në punë. Por, kjo është çështje që do ta diskutojmë në kuvend. Prandaj, kërkoj që ta dimë se cila është arsyeja kryesore për nismën e ndryshimit dhe plotësimin të statutit?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se të gjitha aktet juridike për një mandat duhet të rifreskohen dhe kjo nuk do t'i ndodhë vetëm statutit, por edhe disa rregullore do të ndryshohen. Aktet juridike duhet t'iu përshtaten nevojave të qytetarëve. Andaj, duke parë që statuti i komunës ka zbrazëtira, atëherë komisioni që do të formohet do t'i nxjerr të gjeturat.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, dy (2) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Kurse, në kuadër të kësaj pike, në kuvend të themelohet një komision prej 5 anëtarëve.

6. Rishqyrtimi i vendimit nr.65281/25, i datës 30.12.2025, për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – a mund të na tregoni se pse u kthi ky vendim nga ministria? Në kuvend të na vjen më i detajuar ky material.

Azem Bejta, nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – ky vendim është kthyer nga MAPL-ja me arsyetimin se nuk është precizuar afati kohor i dhënies në shfrytëzim dhe destinimi. Materialet besoj që janë të kompletuara. Kurse, listën e përgjithshme që e ka kërkuar ministria, ajo është e publikuar në web faqe dhe ajo nuk ndryshon. Atë që e ka kërkuar ministria (afatin kohor dhe destinimin), ne e kemi plotësuar

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, dy (2) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – dua t’ju informojë që mbledhja e Kuvendit të Komunës e cila ishte planifikuar që të mbahet më 29 janar 2026 (e enjte) në ora 10:00, do të mbahet të njëjtën ditë (29.01.2025, e enjte), por nga ora 09:00 për shkak të agjendës së kryetarit. Andaj, duhet ta nxjerrim një rekomandim për ndryshimin e këtij orari.

KPF-ja me pesë (5) vota “për”, një (1) “kundër”, rekomandoi që: Mbledhja e Kuvendit të Komunës e cila ishte planifikuar që të mbahet më 29 janar 2026 (e enjte) në ora 10:00, do të mbahet të njëjtën ditë (29.01.2025, e enjte), por nga ora 09:00.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

Bujar Klinaku

Blinaku
Procesmbajtës



Melihate Basholli - Latifi

Melihate Basholli
Kryesuese e KK-së dhe KPF-së